VENDIM
Nr. 168, datë 20.2.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL DHE TË DISA OBJEKTEVE, TË PRONËS NR. 13, ME EMËRTIM "REPARTI USHTARAK NR. 1045", ME VENDNDODHJE NË LAPRAKË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 8 380 (tetë mijë e treqind e tetëdhjetë) m², të pronës nr. 13, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 1045", me vendndodhje në Laprakë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t'i përdorur për rrugë publike, për ndërtimin e segmentit rrugor "Mbikalimi 'Pallati me shigjeta' – rrethrrotullimi 'Shqiponja'", Laprakë, Tiranë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 13, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 1045", me vendndodhje në Laprakë, Tiranë, sipas planvendosjes, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANVENDOSJE

e pronës nr.13 (Sipërfaqja dhe objektet për kalim kapital ARRSH) sipas projektit të unazës të Tiranës



Shkalla 1:1000

PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. Enea SINOIMERI